



VENDIM

Nr. 32 Datë 13.05.2014

MBI

**PROBLEMET E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË
ZONAT INFORMALE DHE PËR KLIENTËT QË NUK PLOTËSOJNË
KUSHTET TEKNIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 51 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës 7.2 të Rregullores për Lidhjet e Reja miratuar me vendimin nr. 22, datë 25.02.2012, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 13.05.2014, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të Liçensuarve mbi problemet e furnizimit të energjisë elektrike në zonat informale dhe për klientët që nuk plotësojnë kushtet teknike,

Konstatohet se:

- CEZ Shpërndarje sh.a në administrim të përkohshëm ka detyrën të kryej shërbimin e furnizimit me energji elektrike në përputhje me Ligjin nr. 9072 date 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe akteve të tjera ligjore për furnizimin me energji të klientëve tarifor sipas standarteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.
- Po ashtu çdo veprim apo mosveprim tjetër i CEZ Shpërndarje që buron nga marrëdhënia e furnizimit me energji elektrike të konsumatoreve tarifore (përfshirë ndërprerjet e energjisë elektrike), duhet të respektojë legjislacionin në fuqi.
- Çdo konsumator që përdor energji elektrike duhet të faturohet sipas regjistrimeve të aparateve matës, siç përcaktuar në nenin 51 të Ligjit nr. 9072, date 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar. Konsumatorët e tjerë të cilët përdorin energji elektrike të pa pajisur me matës duhet të faturohen në përputhje me nenin 52 të këtij ligji dhe Vendimit të ERE nr. 146, datë 24.12.2013, “Mbi kërkesën e CEZ Shpërndarje sh.a në administrim të përkohshëm për vendosjen e faturimit aforfe”.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s.

Vendosi :

1. Për lidhjen e konsumatorëve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, në pamundësi të një dokumentacioni pronësie, të pezullohet për një afat të pacaktuar zbatimi i pikës 3.1. 6 të “Rregullores për Lidhjet e Reja në Rrjetin e Shpërndarjes” miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 22, datë 25.02.2012 .
2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë CEZ Shpërndarje sh.a për vendimin e ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.